


## 5.1 RIFINITURA

### BONIFIN



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes 25 kg/thes	54 cp/paletë 54 cp/paletë	2.5-3kg/m <sup>2</sup>	Gri E Bardhë



#### BONIFIN

Material në formë pluhuri me bazë çimentoje, gëlqereje të hidratuar, rëre guri karbonik me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditive speciale.

#### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Karakterizohet nga hapje dhe punueshmëri mjaft e mirë, gjë që lehtëson aplikimin në sipërfaqe të jashtme dhe të brendshme të mbushura si me llaç tradicional ashtu dhe me llaç të parapërgatitur.
- E aplikueshme në një trashësi deri në 3 mm

#### FUSHAT E APLIKIMIT

I përshtatshëm për realizimin e rifiniturave të sipërfaqeve të mbushura me llaç tradicional ose me llaç të parapërgatitur me bazë çimento - gëlqere. Mund të mbulohet me bojë, ose me veshje të tjera me natyrë minerale dhe sintetike.

#### TE DHËNA TE RËNDËSISHME

- Nuk duhet të shtohen komponentë të tjerë si çimento, gëlqere etj, në produktin e dhënë.
- Nuk duhet të aplikohet mbi sipërfaqe të lyera më parë.
- Nuk duhet të aplikohet mbi sipërfaqe apo mbi veshje plastike.
- Nuk duhet të aplikohet në sipërfaqe me disnivel më të madh se 3 mm.
- Nuk duhet të shtohet uji mbasi përbërja është përgatitur.
- Duhet të aplikohet në temperatura nga +5°C deri +35°C.
- Nuk duhet të aplikohet në vënde ku ka veshje prej qeramike.
- Nuk duhet të aplikohet në sipërfaqe me bazë gipsi.
- Nuk duhet të aplikohet mbi sipërfaqe lehtësisht të thyeshme apo të shkatërruara.

#### PËRGATITJA E SUPORTIT

Sipërfaqja apo suporti ku do të vendoset fino duhet të jetë e niveluar dhe e qëndrueshme. Sipërfaqet me një trashësi më të madhe se 3mm duhet të nivelohen paraprakisht përpara aplikimit të produktit.

#### MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Në një enë hidhni 7.5 - 8 litra ujë dhe 25 Kg BONIFIN. Përziene me një përzierës elektrik me numër të vogël rrotullimesh derisa masa të bëhet homogjene. Për të stimuluar karakteristikat e përzierjes dhe për të pasur një rezultat sa më të mirë, rekomandohet që përzierja të lihet në qetësi rreth 10 minuta dhe para përdorimit të përzihet edhe një herë.

#### MËNYRA E APLIKIMIT TË PRODUKTIT

Materiali duhet të përhapet me një mallë metalike duke siguruar një shtresë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Dora e dytë e materialit duhet të aplikohet 30 minuta mbas aplikimit të dorës së parë. Pasi arrihet tharja e duhur rreth 15 minuta në temperaturë 23°C sipërfaqja duhet fërkuar me përdaf. Temperatura e ambientit ndikon ndjeshëm në kohën e punueshmërisë së produktit. Sa më e ulët të jetë temperatura, aq më shumë zgjatet koha e punueshmërisë.



**TË DHËNAT TEKNIKE (ne +23°C dhe 50% U.R.)**

Raporti i përzierjes	7.5 - 8 litra ujë për 25 Kg BONIFIN
Koha e punueshmërisë	2 - 3 orë
Temperatura e aplikimit	+5°C deri +35°C
pH i përzierjes	12
Trashësia për dorë	2mm
Koha e pritjes për aplikimin e dorës së dytë	30 - 40 min
Koha e pritjes deri në fërkim	15 - 20 min
Koha e pritjes për lyerjen e sipërfaqes	3 - 4 javë
Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri/E Bardhë
Ruatja	12 muaj në paketim origjinal
Djegshmëria	I padjegshëm

**TË DHËNA PËRFUNDIMTARE**

Rezistenca në shtypje mbas 28 ditësh	≥ 3 Nmm <sup>2</sup>
Rezistenca në përkulje mbas 28 ditësh	≥ 1.5 Nmm <sup>2</sup>

